



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislacioni IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme

Mbledhja nr. 48

Prishtinë, më 25 janar 2013, në orën 14:15

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

P r o c e s v e r b a l

**I takimit të Komisionit për Punë të Jashtme me studentët e Shkencave Politike të Universitetit
Leiden të Holandës**

Në takim morën pjesë: Albin Kurti, Hydajet Hyseni, Enis Kervan, Sabri Hamiti, Petar Miletqi.

Mungoi : Skender Hyseni, Donika Kadaj-Bujupi, Emilija Rexhepi.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani, Manush Krasniqi.

Takimin e kryesoi: Albin Kurti, kryetar i Komisionit.

Albin Kurti - I njoftoi të pranishmit se Kosova deri tani është njohur nga gjysma e shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara, nga 22 vende të BE-së dhe se 92%-93% të popullatës së Kosovës, janë shqiptarë. Një ndër sfidat me të cilat përballlet Kosova është Mitrovica, e cila ende është e ndarë, gjë që po e pengon sovranitetin e plotë të Kosovës. Kosova nuk ka ushtri dhe nuk ka kontroll të plotë të kufijve të saj. Gjithashtu, edhe pse mbikëqyrja e protektoratit ndërkombëtar ka përfunduar më 10 shtator, ne ende kemi KFOR-in, i cili është pjesë e NATO-s, EULEX-in, OSBE-në dhe Zyrën e UNMIK-ut. Të gjitha këto autoritete ndërkombëtare janë këtu për të na ndihmuar, por ende nuk na kanë njohur dhe disa nga këto kanë pushtete ekzekutive mbi ne, si dhe imunitet ligjor. Sfida tjetër e Kosovës është zhvillimi ekonomik. Fatkeqësisht, gjysma e popullatës është e papunësuar, 38% e popullatës jeton me më pak se 2\$ në ditë, 18% e popullatës jetojnë në varfëri ekstreme me më pak se 1\$ në ditë, ndërsa proporcioni eksport-import është 1 me 11.

Paqja e cila shihet në rrugët e Kosovës, është meritë e diasporës sonë, të cilët ju dërgojnë para familjeve të tyre në Kosovë për konsumim, e jo për prodhim apo investim. Komisioni për Punë të Jashtme, përveç interesimit që ka për ta rritur numrin e njohjeve, është i interesuar që të lidhë edhe marrëveshje me këto vende.

Hydajet Hyseni - E përshkroi Kosovën si një ujdhesë pa det me një fat të pazakonshëm. Ai bëri të ditur se, me shënjë, Kosova ka qenë nën okupimin e huaj dhe e ekspozuar në gjenocide të dhunshme, të cilat kishin qëllim pastrimin etnik të saj.

Kosova tani është e lirë, ka ambicie për të qenë e barabartë me të tjerët dhe ka vështirësi shumë serioze. Si pasojë e politikave të pastrimit etnik, Kosova ka një numër të madh të popullit, të cilët jetojnë në vende të tjera të botës. Njoftoi edhe për praninë ndërkombëtare në Kosovë, për të cilën shprehi mirënjohje, e njëkohësisht ceku edhe mënyrën arbitrare të funksionimit të saj. Gjithashtu, theksoi kufizimin e lirisë së qarkullimit dhe aspiratat e Kosovës për integrim në Evropë.

Sabri Hamiti – U prezantua. Kosovën e përshkroi si një vend në kërkim. Ai tha se gjuha shqipe është një ndër gjuhët më të vjetra në Ballkan dhe në Evropë me origjinë të veçantë. Kosova është vend që e ushtron tolerancën fetare me një popull i cili ka tri besime, atë ortodoks, katolik dhe mysliman. Njoftoi se Kosova ka një emër antik, që quhet Dardani dhe udhëheqësi ynë, Ibrahim Rugova, mendonte që Kosova do të duhej ta kishte këtë emër.

Studentët e Shkencave Politike të Universitetit Leiden të Holandës - Kërkuan të njoftohen nga anëtarët e Komisionit se: me çfarë problemesh ballafaqohen me rastin e implementimit të politikave të tyre me kaq shumë grupe etnike; si planifikojnë ta rrisin numrin e njohjeve; a e konsiderojnë veten si kosovarë apo si shqiptarë; a mendojnë se shumë qytetarë të Kosovës duan të jenë pjesë e Shqipërisë; cili është dallimi më i madh sa u përket partive politike në Kosovë; në çfarë mënyre mund t'ju ndihmojë Shqipëria, në mënyrë që të mos jenë një ishull, por një gadishull; a ekziston politika për kthimin e trurit, si dhe a përfaqësohen partitë e komunitetit serb në Kuvend.

Albin Kurti – Bëri të ditur se përkundër përpjekjeve të ndërkombëtarëve që integrimi i komuniteteve të bëhet përmes seminareve dhe konferencave, integrimi i vërtetë bëhet përmes zhvillimit ekonomik. Në Kosovë ka disa parti politike serbe. Nga komuniteti serb, z. Petar Miletqi është nënkryetar i Kuvendit. Po ashtu, në Qeveri janë dy ministra dhe një zëvendëskryeministër nga komuniteti serb. Lidhur me pyetjen për planifikim të rritjes së numrit të njohjeve, tha se është një fushëbetejë shumë e madhe, për shkak të propagandës serbe dhe distribuimit të informatave të gabuara për shqiptarët. Identiteti shqiptar është shumë i fuqishëm kurse ai kosovar nuk është primar dhe është më shumë gjeografik. Sipas disa sondazheve, shumica e shqiptarëve të Kosovës dhe të Shqipërisë janë në favor të bashkimit, në Kosovë mbi 80% dhe në Shqipëri mbi 60%. Kushtetuta e Kosovës, neni 1.3 i saj, nuk e lejon Kosovën të bashkohet me një vend tjetër, gjë që nuk është e drejtë dhe do të duhej që populli të ketë të drejtën e referendumit dhe të vendos për këtë çështje. Kushtetuta e Kosovës mund të ndryshohet, por është shumë e vështirë, sepse nevojitet përkrahja e shumicës së deputetëve të komunitetit serb. Sa i përket ikjes së trurit, tha se është e vërtetë që shumë njerëz kanë dalë jashtë vendit dhe shumë nga ata kanë diploma universitare, por ata nuk mund të kthehen këtu, sepse Kosovës i mungon zhvillimi. Theksoi se nuk është kundër privatizimit në Kosovë, por se duhet ditur çfarë të privatizojmë, kur, sa, si dhe kujt. Privatizimi nuk ka krijuar vende pune, në fakt, ai ka larguar njerëz nga puna. Njoftoi se Kosova ka më së shumti nevojë për vende pune për të rinjtë dhe për një plan për zhvillimin ekonomik.

Enis Kervan – Tha se Kosova është një shtet ku të gjitha komunitetet e kanë gjetur veten brenda saj. Komuniteti turk, të cilit ai i takon, nga koha e presidentit Rugova, ka qenë i integruar në realitetin e Kosovës dhe të popullatës shumicë shqiptare. Në Kosovë, të gjitha komunitetet janë të përfaqësuara, duke filluar nga institucionet qendrore, deri tek ato lokale. Ky është një shembull i mirë për tërë botën në aspektin e integritit dhe përfaqësimit të komuniteteve në Kosovë. Ky realitet i përfshirjes së komuniteteve, do të duhej të merrej si element i rëndësishëm, i cili ndikon në njohjen e Kosovës. Njoftoi se pos gjuhës shqipe e gjuhës serbe, si gjuhë zyrtare në Kuvendin e Kosovës është në përdorim edhe gjuha turke. Gjuha turke në disa komuna njihet si gjuhë zyrtare.

Sabri Hamiti - Duke u ndërlidhur me pyetjet e parashtruara nga studentët, vuri në pah se, historikisht, etnitete ka edhe në Francë, edhe në Belgjikë dhe në vende të tjera të Evropës. Sa i përket Kosovës, ajo është një modernitet që e ka lënë anash historinë. Me kolegët e nacionalitetit turk dhe serb, nën sundimin e të cilëve ka qenë Kosova me shekuj, jemi anëtarë të barabartë në Kryesinë e Kuvendit. Qarkullimi në mes të Shqipërisë dhe Kosovës, më në fund, është i lirë dhe shumë i shpejtë. Ekziston një kanal i mirë i komunikimit në aspektin ekonomik, kulturor dhe politik në mes të dy vendeve. Partia e LDK-së, e ka pasur në program Kosovën e pavarur e demokratike. Pa Kosovën e pavarur dhe demokratike, nuk ka as integritet shqiptarë në Ballkan, e as integritet evropian. Ky program i Kosovës demokratike dhe të pavarur është rrugë për shprishje kufijsh që pengojnë komunikimet rajonale dhe evropiane. Historia e ndarjes së tokave shqiptare fillon në shekullin e XX, ndërsa tani tentojnë të bashkohen në një shtet, nëse jo, të funksionojnë si një shoqëri demokratike pa pengesa. Partitë politike dallojnë shumë për nga programi i tyre, por ato kanë konsensus nacional rreth integritetit evropian. I takoj partisë së LDK-së, e cila është themeluar në vitin 1989 dhe është udhëhequr nga presidenti Ibrahim Rugova, deri në vdekjen e tij. Partia është e qendrës së djathtë dhe është anëtare e asocuar e Partive Popullore Evropiane.

Hydajet Hyseni - Lidhur me çështjet etnike, vuri në pah se është pak paradoksale që Kosova, me 90% kombësi kompakte, konsiderohet multietnike dhe Kushtetuta e saj është ndërtuar mbi këtë premisë, ndërsa vendet fqinje, që nuk e kanë as gjysmën e popullatës kompakte, nuk e kanë këtë karakter multietnik. Ne e kemi pranuar një favorizim të pakicave apo diskriminim pozitiv, mirëpo kur një komunitet favorizohet tej mase, krijohen raporte të pabarabarta në mes të komuniteteve, gjë që krijon mundësi të instrumentalizimit dhe të bllokimit. E kaluara në Kosovë nuk ka qenë konflikt ndërfetar e ndëretnik siç shpesh prezantohet si e tillë. E kaluara në Kosovë ka qenë konflikt në mes të një populli të robëruar, i ekspozuar politikës shfarosëse dhe gjenociduese të pushtetit, e jo në mes të pjesëtarëve të komuniteteve të ndryshme. Shqiptarët janë popull i ndarë, si pasojë e strategjisë për shpërbërjen e tyre. Në kohën kur Evropa integrohet e bashkohet dhe i kalon vështirësitë historike, tek ne vendosen kufijtë në mes të territoreve, që kanë qenë territore shqiptare. Kompromisi i bërë me pakon e Ahtisaarit, konsiderohet të jetë zgjidhje maksimale, por kërkesa që të imponohet tani argumenti etnik në një pjesë të Kosovës, parashtron nevojën për zgjidhje të njëjtë për gjithë problemin e shqiptarëve. Përkundër vullnetit kooperues të Qeverisë së Kosovës në procesin e dialogut me Serbinë, përgjigjja e tyre është se nuk e njohin pavarësinë e Kosovës. Dy ditë pas këtij dialogu, forcat e armatosura serbe në Preshevën e banuar me popullsi shqiptare, me dhunë brutale e rrënojnë monumentin me emrat e martirëve, të vrarë gjatë rezistencës kundër regjimit të Millosheviqit.

Takimi përfundoi në orën 15:40.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Albin Kurti